39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrim i pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 621-21-1000-5-2-1/C433

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|-------------------------------------------|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|                                           | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>nuk kerkohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | <p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat];</li> <li>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat];</li> <li>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat];</li> <li>(d) dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat]</li> <li>ii. të personave të tjerë: [shëno shumat]</li> </ul> </li> </ul> |
| Programi                                  | 12.1      | Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                                           | 12.2      | Periudha për Programin e azhurnuar është <b>2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Fillimi i punëve                          | 17.1      | Data e fillimit do të jetë 2 dite nga data e nënshkrimit të kontratës, ose 28.04.2021, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme/ vlersimi i organit mbikqyres të Autoritetit kontraktues.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|                                           | 17.2      | <b>Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 50 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Dëmet e likuiduara                        | 19.1      | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|                                           |           | Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |


|                                                    |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|----------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                    |      | Çmimit final të Kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Regjistri i punës                                  | 20.1 | [Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Inspektimi dhe testimi                             | 22.1 | <p>Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve , i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Asnjë ekzekutim i punëve- nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve- të Autoritetit Kontraktues</p> <p>Menagjeri i kontrates nga AK është Bean Haxhiasi</p> <p>Menagjeri i projektit nga AK është Xhyllbehar Taipi</p> <p>Menagjeri i projektit nga OE është Ylli Qafleshi</p> |
| Pagesa                                             | 24.2 | <p>Sipas raportit të prezantuar-dorezuar nga menagjeri i projektit nga ana e organit mbikqyres,dhe të pranuar nga ana e komisionit për pranim teknik me një raport.</p> <p>Pagesa do të kryhet në afat sa më të shkurter kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të fatures.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Parapagimi                                         | 26.1 | Shuma e Parapagimit është:                   nuk aplikohet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Mbajtja e Parasë                                   | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: <b>10 % e vlerës së kontratës, nga data e pranimit të punëve për periudhën një vjeçare</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Përgjegjësi mbi Defektet                           | 34.5 | <p>Periudha garantuere e defekteve është /2 muaj nga data e pranimit teknik të perkoheshem.</p> <p>Dokumenti Polisa e sigurimit të leshuar nga një Bankë apo Kompani e sigurimeve të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, me afat valediteti për 12 muaj nga data e pranimit teknik të perkoheshem të punëve.</p>                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës                 | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2 | <b>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | <p>[shëno te dyja]</p> <p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund</p>                                                                                                                                                                                                      |

|  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  | <p>të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës</b>, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>a) Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p> |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

**KUBËZIMI I RRUGËS DHE INFRASTRUKURËS TJETËR NË FSHATINË DIKANCË**

**1. KUBËZIMI I RRUGËS AKSI 3; S=43.22m<sup>2</sup>**

| Nr. rendor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Përshkrimi i pozicioneve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Njësia | Sasia | Çmimi njësi (€) | Çmimi total me TVSH (€) |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-----------------|-------------------------|
| Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me njetet sinjalizuese para fillimit të punët, nëgjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore tëqytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |        |       |                 |                         |
| 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | PUNËT PREGADITORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |        |       |                 |                         |
| 1.1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | m2     | 43.22 | 0.10 €          | 4.32 €                  |
| 1.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubëzave në rruget lokale të Fshatit. Llog m2 | m2     | 43.22 | 0.30 €          | 12.97 €                 |
| 1.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m'                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | m2     | 43.22 | 0.30 €          | 12.97 €                 |
| Gjithsej: Pos 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |        |       |                 | 30.25 €                 |
| 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | PUNIMET TOKËSORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |        |       |                 |                         |
| Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashesi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |        |       |                 |                         |
| 2.1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Gërmimi me makinceri (70%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | m3     | 13.31 | 2.00 €          | 26.62 €                 |
| 2.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Gërmimi me dorë (20%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | m3     | 6.66  | 2.50 €          | 16.64 €                 |
| 2.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Gërmimi me çekan (10%)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | m3     | 3.33  | 2.50 €          | 8.32 €                  |
| 2.4                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rruges , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | m2     | 43.22 | 0.30 €          | 12.97 €                 |




|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                       |                 |       |        |          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|-------|--------|----------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                       | Gjithsej: Pos 2 |       |        | 64.55 €  |
| 3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | PUNIMET E MBUSHJES ( TAMPONT)                                                                                                                                                                                                                         |                 |       |        |          |
| Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63 ) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet të jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.<br>Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.                                               |                                                                                                                                                                                                                                                       |                 |       |        |          |
| 3.1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm                                                                                                                                                                      | m3              | 10.37 | 3.00 € | 31.12 €  |
| Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rruges , me materiali guror nga gurit të thyer fraksion( 0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet të jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 .<br>Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.                                            |                                                                                                                                                                                                                                                       |                 |       |        |          |
| 3.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm                                                                                                                                                                | m3              | 5.19  | 3.00 € | 15.56 €  |
| Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                       |                 |       |        |          |
| 3.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm                                                                                                                                                                      | m3              | 2.59  | 3.00 € | 7.78 €   |
| Gjithsej: Pos 3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                       |                 |       |        | 54.46 €  |
